



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E MZSH –SE

Nr. prot

Durrës, më 08.01.2026

Lënda: Kthim përgjigje emisioni “Veting”/ News24

Në bazë të kërkesës tuaj, emisioni “Veting”/ News24 për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit nga Drejtoria e shërbimit të “Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit” Bashkia Durrës ju vëmë në dispozicion dokumentacionin dhe masat e marra nga ana jonë si më poshtë, bazuar ne kërkesën tuaj.

1. Masat e marra nga Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi i Bashkisë Durrës pas ndërhyrjes në shpërthimin e raportuar në zonën e Porto Romanos te depozitave të hidrokarbureve.

Me datë 16.12.2025 ora 09:30 është marrë informacin nga salla operative e MZSH-së Bashkia Durrës se në depozitat e karburantit të subjektit “BOLV OIL” (“PORTO ROMANO OIL”SHA) në Porto Romano, ka rënë zjarr. Menjëher është nisur grupi i ndërhyrjes për në vendngjarje dhe po në të njëjtën kohë janë nisur edhe dy stacione të tjera, ai i Autoritetit Portual Durrës dhe stacioni zjarrfikës Plazh. Bashkënjgitur ju vëmë në dispozicion “Raportin e Ndërhyrjes” për veprimet e mëtejshme.

Nga Drejtoria e MZSH-së ju bëjmë me dije se subjekti “PORTO ROMANO OIL”SHA është inspektuar me datë 07.11.2025 në orën 10:00 ku janë lënë detyrë me afat të riparojë sistemet e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit me procesverbal inspektimi me nr.serie 0000241, dhe me afat inspektimi deri më datë 24.12.2025.

2. Data dhe ora e ndërhyrjes.
Data 16.12.2025 ora 09:30.
3. Raport zyrtar teknik të hartuar nga shërbimi zjarrfikës lidhur me shkaqet paraprake të shpërthimit.

Nga Drejtoria e MZSH-së Bashkia Durrës është konstatuar shkelje e masave gjatë kryerjes së punimeve në subjekt dhe është mbajtur procesverbal inspektimi nr.serie 0000260.

4. Masat e marra ose të rekomanduara ndaj subjekteve në fjalë.

Nga Drejtoria e MZSH-së Bashkia Durrës ndaj subjektit “PORTO ROMANO OIL”SHA është marrë marrë masë administrative me nr.serie 0000027 dhe AKT BLOKIMI me nr.serie 0000006.

Bashkëngjitur po ju dërgojmë një kopje të dokumentacionit përkatës.

Faleminderit për mirkuptimin.

DREJTORIA E MZSH-së BASHKIA DURRËS